




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



Njësia e personelit / Kadrovska Jedinica/Personnel Unit



Për/Za/To: Z.Smajl Latifin, Kryetar i komunës së Rahovecit

Nga/Od/From: Ymret Reshiti, Udhëheqësi i personelit të komunës së Rahovecit

Lënda /Svrha/Subjekt/: Raporti tre mujor i punës për periudhën Janar-Mars 2022

I nderuar Kryetar.

Po iu prezantoj raportin tre mujor të punës për periudhën Janar-Mars 2022, të Njesisë së Personelit të administratës të komunës së Rahovecit.

1. REKRUTIMET(Lëvizjet paralele dhe Ngritjet në detyrë)

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 25 konkurse publike në shërbimin civil, prej të cilave 9 janë konkurse (të brendshme) -“Lëvizje paralele” dhe 16 konkurse të jashtme –pranim në punë.

Prej 16 konkurseve –pranim, kemi 2 konkurse që kanë përfunduar me sukses dhe janë punësuar 2 punëtor të rinj, ndërsa 14 konkurse tjera janë në fazat e zhvillimit.

Pozitat që janë plotësuar me punëtor të rinj janë:

- 1.Zyrtar për regjistrimin e biznesit në Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim.
- 2.Zyrtar për barazi gjinore në Drejtorinë për Administratë.

Është shpallur një konkurs publik –pranim në punë nga kategoria e stafit mbështetës dhe teknik, dhe është plotësuar me punëtor të ri, kjo pozitë e lirë;

- 1.Roje pylli pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Të gjitha procedurat e shërbimit civil realizohen përmes programeve elektronike që është unike për Republikën e Kosovës.

Në Drejtorin e Arsimit kemi shpallur gjithsej 13 konkurse.

Në Drejtorinë e Shëndetësisë kemi shpallur kemi shpallur gjithsej 3 konkurse.

Tani, Njësia e Personelit i shpall konkurset publike edhe për sektorin e arsimit dhe sektorin e shëndetësisë në programin elektronik: hrms.rks-gov.net.

2. PUSHIMET VJETORE

-Punëtorët janë duke shfrytëzuar ditët e mbetura të pushimit vjetor të vitit 2021, ku afati i fundit është data 30.06.2022.

Dy punëtore aktualisht janë duke shfrytëzuar pushimin e lehonisë.

Rekomandohet të respektohet Rregullorja për Pushimet e Nëpunësve Civil.

3. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

-Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 105 shkresa administrative, si në vijim: Kontrata, vërtetime, vendime, draft vendime, propozim, akt emërimi, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa tjera si dhe ka dërguar mbi 100 emaille zyrtare.

4. TABELAT STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e personelit i procedon drejtpërdrejt në programin elektronik SIMBNJ sipas kërkesës së MPB/DASHC-së, që bëhet rregullisht. Njësia e personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

-Administrata komunale ka gjithsej 161 pozita, pa sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Prej këtyre të plotësuara janë 141 pozita, ndërsa 20 pozita janë të lira.

5. VLËRËSIMI I PUNËS PROVUESE

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk kemi pasur asnjë rast të vlerësimit të punës provuese.

6. VIJUESHMËRIA E PUNËTORËVE NË PUNË

Funksionon Sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP.

Njësia e personelit rregullisht në çdo muaj i dërgon drejtorive komunale dhe zyrave raportin e vijueshmërisë së punës, dhe kërkon nga menaxhmenti që të verifikoj mungesat e punëtorëve në punë.

7. TRANSFERIMIET E PUNËTORËVE /AVANCIMET /NDRYSHIMET NË POZITË

Gjatë kësaj periudhe ka pasur vetëm një bartje të një punëtorit nga një drejtori në tjetrën, pa iu ndërruar titulli i punës dhe koeficienti i pagës –Shofer.

8. NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Gjatë kësaj periudhe dy (2) punëtorëve iu ka pushuar marrëdhënia e punës:

1. Ali Kryeziu nga Xërxa, gjeometër - pensionim.
2. 2.Edmond Kabashi nga Opterusha –dorëheqje.

9. TRAJNIMET E NËPUNËSVE CIVIL

Udhëheqësi i personelit i ka njoftuar me kohë punëtorët për trajnimet.

Është hartuar Plani i trajnimit të nëpunësve civil të komunës për vitin 2022 dhe është dërguar në DASHC/ MAP.

10. VENDIMET NGA KPMSHCK-së

Nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës nuk kemi asnjë vendim.

11.TË DHËNAT NGA KOMISIONET E SHËRBIMIT CIVIL TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

I. Komisioni Disiplinor

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë rast për ndjekje disiplinore.

I. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë ankesë.

Njësia e personelit i kryen punët e sekretarisë për Komisionin Disiplinor dhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke i lëshuar shkresat administrative përveç vendimeve, të cilat nuk ka të drejtë.

12.MENAXHIMI I BURIMEVE NJËRËZORE SIPAS PROGRAMIT “ SIMBNJ”.

Në vazhdimësi Njësia e personelit menaxhon me programin elektronik SIMBNJ duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program sipas kërkesave që parashtron MPB-ja. Ky program është i dizajnuar për menaxhimin elektronik të burimeve njerëzore dhe ka hyrë si prioritet i reformës së administratës shtetërore të Qeverisë së Kosovës. Aktualisht programi SIMBNJ nuk është aktiv në shumë pjesë por po punohet në këtë drejtim nga MPB-ja.

13.PLANI INDIVIDUAL I PERSONELIT

Njësia e personelit ka hartuar draft Planin Individual të Personelit të komunës së Rahovecit për vitin 2022 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

Asnjë punësim në administratën komunale nuk mund të realizohet nëse pozitat nuk janë të përfshira në Planin Individual të Personeli .

14.ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE ELEKTRONIKE

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth, Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore .
- Menaxhon me programin elektronik hrms.rks.gov-net ku realizohen procedurat e rekrutimit .
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punët të punëtorëve –pra programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.
- Monitoron me programin elektronik PYROLL , pra programit të listave pagave dhe pagesave të komunës.